



Republika e Kosovës
Republikë Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.1055/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave në përbërje nga: Eshref Shabani-kryetar, Jeton Koca dhe Arditë Haxhnikaj Demi-anëtarë, me Flakron Gashi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, në bashkëpunim me numër A.nr.1055/2023 të datës 02.08.2023 të parashtruar nga ankuesi [] të cilën me autorizim e përfaqëson Avokate [] me adresë: [] Prishtinë, kundër institucionit banka Qendrore e Republikës së Kosovës, në çështjen juridike "kërkesë nga marrëdhënia e punës", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.8 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datën 08.09.2023, mori këtë vendim:

V E N D I M

I. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, shpallet **jo kompetent** për të vendosur për ankesën me numër A.nr.1055/2023 të datës 02.08.2023, të parashtruar nga ankuesi []

II. Lënda i dërgohet organit të punësimit/Banka Qendrore e Republikës së Kosovës.

A r s y e t i m

Ankuesi [], përmes përfaqësuesit të autorizuar, më datë 29.07.2023 përmes poste ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës e cila në Këshill është pranuar me datë 02.08.2023 dhe regjistruar nën shenjë A.nr.1055/2023 me numër protokoll:5492/2023, me pretendimet ankimor se institucioni punëdhënës është duke ia shkelur të drejtat elementare që burojnë nga marrëdhënie punës për shkak se nuk është duke ia vazhduar pushim pa pagesë, pavarësisht gjendjes së rënduar shëndetësore të ankuesit.

Kolegji i Këshillit nga administrimi i shkresave të lëndës ka gjetur se ankuesi në bazë të Kontratës së Punës të datës 15.12.2015 e ka lidhur fillimisht marrëdhënien e punës me Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës në pozitën e punës "Mbikëqyrës i Ri i Sigurimeve", ndërsa sipas Kontratës së Punës të datës 01.02.2020 i njëjti mban pozitën e punës "Zyrtar i Lartë" në kuadër të Departamentit të Administratës pranë Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës.

Lidhur kompetencën e shqyrtimit të ankesës së ankuesit, Kolegji i Këshillit ka analizuar dispozitat e Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, përkatësisht neni 2 paragrafi 3 ku përcaktohet se: *"Nëpunës Civil - është zyrtari publik në kuadër të Shërbimit Civil, i cili ushtron detyrën në një pozitë, duke filluar nga zyrtari profesional deri në pozitën e sekretarit të përgjithshëm në administratën e Presidentit, në administratën e Kuvendit, në Zyrën e Kryeministrit, në ministri, në agjenci ekzekutive, në agjenci dhe në një degë lokale të tyre, në administratën e institucioneve të sistemit të drejtësisë, në institucion të pavarur, në agjenci të pavarur, në administratën komunale dhe çdo nëpunës i përcaktuar drejtpërdrejt me ligj të veçantë."* dhe po ashtu ka analizuar edhe dispozitat e aplikuara të nenit 73 të Ligjit Nr. 03/L-209 për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës i plotësuar dhe ndryshuar sipas Ligjit Nr. 05/L - 150 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.03/L-209 për Bankën Qendrore për Republikën së Kosovës ku përcaktohet se: *"1. Në rast se dispozitat e këtij Ligji bien ndesh me ato të ligjeve të tjera, atëherë dispozitat e këtij Ligji do të mbizotërojnë. 2. Banka Qendrore nuk do t'i nënshtrohet asnjë dispozite ligjore që do të vështirësonte arritjen e objektivave të Bankës Qendrore, të referuara në nenin 7, paragrafët 1 dhe 2 të këtij ligji, si dhe realizimin e detyrave të saj të lidhura me to. Në veçanti, Banka Qendrore nuk do t'i nënshtrohet ligjeve në vijim: Ligji mbi Shërbimin Civil, Ligji mbi Prokurimin Publik, Ligji mbi Auditimin e Brendshëm, dhe Ligji mbi themelimin e Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm të Kosovës dhe Zyrën e Auditorit të Kosovës. 3. Dispozitat e këtij ligji nuk do të revokohen, anulohen, ndryshohen apo zëvendësohen, tërësisht ose pjesërisht, nga ligje të tjera, përveç nëse legjislacioni i pastajmë ndryshon në mënyrë specifike këtë ligj, dhe çdo ndryshim i tillë do të kërkojë konsultime paraprake me Bankën Qendrore"* dhe ka ardhur në përfundimin se të punësuarit në Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës, respektivisht ankuesi në rastin konkret nuk e ka statusin e nëpunësit civil, madje Banka Qendrore sipas përcaktimeve ligjore të legjislacionit të veçantë nuk i nënshtrohet fare legjislacionit mbi Shërbimin Civil.

Andaj, duke marr parasysh faktin pas konstatimit se ankuesi nuk e ka statusin e nëpunësit civil, Kolegji i Këshillit konstaton se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës nuk është kompetent për të vendosur për ankesën me numër A.nr.1055/2023 të datës 02.08.2023 të parashtruar nga ankuesi ngase sipas dispozitave të nenit 6 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Këshilli është kompetent për të shqyrtuar vetëm ankesat e nëpunësve civilë dhe kandidatëve për pranim në Shërbimin Civil, e që në rrethanat e rastit konkret asnjëri nga këto dy parakushte ligjore nuk është i plotësuar.

Si rrjedhojë, nga çfarë u tha si më lartë, Kolegji i Këshillit duke marrë përbazë legjislacionin e veçantë të Bankës Qendrore të Kosovës, respektivisht sipas përmbajtjes normative të dispozitave të Ligjit Nr.03/L-209 për Bankën Qendrore për Republikën së Kosovës, vlerëson se institucioni punëdhënës i ankuesit është autoriteti kompetent për shqyrtimin fillestarë të ankesave të brendshme dhe më pastaj në varësi të rregulla të brendshme procedurale palët mund t'i udhëzojnë në mjete juridike, andaj mbi këtë bazë ankesa e ankuesit me të gjitha shkresat e parashtruara të lëndës bartet tek Banka Qendrore e Republikës së Kosovës

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës, si dhe duke u bazuar në nenin 6 paragrafi 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.8 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.1055/2023

Elakron GASHI

Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional

Eshref SHABANI

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dërgohet

- Përfaqësueses së ankuesit,
- Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës, dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.